



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr 05/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të pandehurit F.R nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme, të parashikuar nga neni 332 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.800//2015, datë 09.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë me dt. 15.08.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ibrahim Fejza, të dëmtuarit M.R.1 dhe të pandehurit, me datë 16.08.2019 shpalli publikisht, ndërsa me datë 27.08.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.R, nga i ati H., e ëma H., e vajzërisë P., i lindur me datë ... në ..., me vendbanim në fshatin ..., komuna e ..., ku edhe tani jeton, i pa punë, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ..., shqiptarë, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

sepse,

Nga data e pacaktuar e vitit 2014 e deri më tani, në fshatin ... - komuna e ..., i pandehuri, në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar pronën e paluajtshme të të dëmtuarit M.R., e cila pronë bazuar në aktvendimin mbi ndarjen e tokës me komosacion nga komisioni komunal për komasacion të komunës së Mitrovicës, datë 11.04.1988 evidentohet si ngastër – pronë në emër të babait të të dëmtuarit M.R.1, M.R.2, dhe atë me kulturë arë, klasa II, me sipërfaqe 0.49,19 ha, e cila gjendet në fshatin ..., komuna e ..., të cilën pronë i pandehuri e ka mbjellë dhe e ka shfrytëzuar pa autorizim, e të cilën pronë i dëmtuari disa herë ka kërkuar që t'i lirohet.

Me këtë ka kryer veprën penale: Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 49, 50, 51, 52, 73, e 74, të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej një (1) vjetëve nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

2. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 30€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
3. Obligohet i pandehuri që ta liroj pronën e lartcekur, brenda afatit 15 ditësh të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
4. Pala e dëmtuar, M.R.1, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.800/2015 të datës 09.01.2018, kundër të pandehurit F.R nga ... për shkak të veprës penale: Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësorë me dt.15.08.2019 ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës.

Në lidhje me pranimin e fajësisë prokurori i shtetit ka deklaruar se konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, ky pranim është i mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, kërkojmë nga Gjykata që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, duke pasur parasysh se edhe vet ligji pranimin e fajësisë e merr si rrethanë lehtësuese.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, në mbështetje të nenit 248 e lidhur me nenin 326 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti policor me numër të rastit ... i datës 08.10.2014; Deklarata e të pandehurit F.R e dhënë në polici e dt. 29.09.2014; Deklarata e të dëmtuarit M.R.1 dates 05.08.2014; Aktvendimi mbi ndarjen e tokës me komosacion, i datës 11.04.1988. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo mund të bëjë ankesë sa i përket lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se, mbetem në tërësi pranë akuzës të ngritur kundër të pandehurit për veprën penale ashtu siç është përcaktuar sot në fillim të shqyrtimit gjyqësorë, për të cilën veprën penale i akuzuari e ka pranuar fajësinë, kërkojmë nga Gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, dhe pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese ashtu siç e parasheh ligji.

I akuzuari F.R në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: është e vërtet se prindërit tanë kanë qenë shokë të mirë dhe ne edhe si familje kemi pasur raporte të mira, unë tani e tutje nuk e shfrytëzoj atë pronë dhe e lus Gjykatën që t'i merr parasysh rrethanat lehtësuese se jetoj vetëm nga një ndihmë sociale prej 82.50 euro, jetoj vetëm me bashkëshorten e cila po ashtu nuk punon.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Uzurpim i paligjshëm i pronës se paluajtshme nga neni 332 par.1 të KPRK, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPRK-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur mënyrën e kryerjes së veprës penale, gjë që nga provat rezulton se i pandehuri këtë veprë e kishte kryer me dashje dhe me qëllim të përfitimit material për vete.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shpreh keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, faktin se tashmë nuk e shfrytëzon atë ngastër, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë, rrethanat personale, pasi që është mbajtës i familjes, kushtet e vështira pasi që jeton vetëm nga të ardhurat e ndihmës sociale e pa të ardhura të tjera.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me burg me kusht ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Poashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen i pandehuri të përmbahet nga vozitja në gjendje të dehur.

Gjykata si në dispozitiv të Aktgjykimi ndaj të pandehurit e ka obliguar që ta lirojë pronë, duke qenë se i njëjti e ka pranuar se ajo pronë nuk është e tij dhe se nuk ka ndonjë bazë juridike mbi të cilën e ka shfrytëzuar.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, Gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 463 të KPP-së, pasi që i dëmtuari nuk ka paraqitur vlerë të saktë të dëmit të pretenduar.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 463 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr 05/2018, dt.27.08.2019

Procesmbajtësja
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.